



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:177605

Datë: 07.12.2021

Numri i dokumentit: 02480911

P.nr.1002/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Fikrije Rexhepi, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.A nga fsh. e Gjilanit, ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349, paragrafi 1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2104/20, të datës 15.12.2020, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Huma Jetishi , pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 07.12.2021 publikisht shpalli, ndërsa më 07.12.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S.A** nga i ati **A**, e ëma **F**, e lindur **S**, I lindur në Gjilan , me vendbanim në fshatin ... Gjilanit, baba i tre fëmijeve, ka të kryer shkollen fillore, me gjendjes të varfër ekonomike ekstreme, me nr personalshqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar.

Është fajtor

Sepse:

Më datën 02.10.2020, rreth orës 18:10, në territorin e fshatit....., Komuna e Gjilanit, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur "B....", i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka vjedhur dru në atë mënyrë që me sharrë motorike ka prerë 58 copa dru të lojit bung me diametër në cung 14-16 cm në lartësi të drurit 11 cm dhe gjatësi 7 m me vëllim të përgjithshëm prej 2.71 m³, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmturaës APK-së në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 346.88 Euro,

-me çka ka kryer veprën penale **Vjedhje pylli nga neni 349, paragrafi 1 , të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarit i S.A i caktohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditë, dhe ne të njëjtën kohë urdhërohet që ky dënim mos të ekzekutohet, nese i akuzuari në fjalë nuk kryen veper tjeter penale gjat periudhës verifikuese ne afat prej një (1) viti ,duke filluar nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi,nën kërcënim të revokimit të tij të nenit 50 ose 51 të KPRK-së.

I pandehuri S.A obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej njëzet (20) euro, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari, **AKP në Gjilan**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri S.A obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej njëzet (20) euro, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari, **AKP në Gjilan**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y t i m

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 15.12.2020, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2104/2020, kundër të pandehurit S.A për shkak të veprës penale, Vjedhje pylli nga neni 349, paragrafi 1, të KPRK-së. Në shqyrtimin fillestar të datës 07.12.2021 ishin prezent Prokurorja e shtetit Huma Jetishi, dhe i pandehuri S.A. Në të cilën seancë i pandehuri S.A pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit S.A, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri S.A, ka kryer veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 349, paragrafi 1, të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 349 të KPRK-së, paragrafi 1, të KPRK-së Vjedhja pylli konsiderohet:

1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim me gjobë me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehurit S.A si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, i njëjti është në gjendje tepër të varfër ekonomike, i njëjti drutë i ka marrë për nevoja familjare dhe jo për shitje, ndërsa rrethanë rënduese është rrezikshmëria e veprës penale dhe dëmin material që i njëjti i'a ka shkaktuar të dëmtuarës AKP-s n Gjilan.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit S.A duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e saj, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

I pandehuri S.A obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **20.00 € (njëzet euro)**, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Divizioni penal
P.nr.1002/20, më 07.12.2021

Sekretarja Juridike
Fikrije Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli.

NË EMËR TË POPULLIT

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S.A** nga i ati Murat , e ëma Huma , e lindur Kameri , I lindur m 01.11.1976 në fsh. Selishtë, K. e Gjilanit ku dhe jeton, baba i shtatë fëmijeve shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me gjendje të varfër ekonomike, shfrytëzues i ndhimes sociale, me nr personal 1005820576 i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

Më datën 02.10.2020, rreth orës 18:10, në territorin e fshatit Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur “Butash”, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka vjedhur dru në atë mënyrë që me sharrë motorike ka prerë 58 copa dru të lojit bung me diametër në cung 14-16 cm në lartësi të drurit 11 cm dhe gjatësi 7 m me vëllim të përgjithshëm prej 2.71 m³, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmturaës APK-së në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 346.88 Euro,

-me çka ka kryer veprën penale **Vjedhje pylli nga neni 349, paragrafi 1 , të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit S.A, i shqiptohet **dënimi me burg gjashtëdhjet (60) ditë**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese **prej 1 (një) viti**, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri S.A obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej njëzet (20) euro, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari, **AKP në Gjilan**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Gjyqtari pas shpalljes së aktgjykimit dha një arsyetim të shkurt e në bazë të nenit 368 të kPP palët i udhëzoj për të drejtën në ankesë.

Përfundoi në ora 09.20 min.

V ë r t e t o j n ë

Numri i lëndës: 2020:177605
Datë: 07.12.2021
Numri i dokumentit: 02480911

Sek. juridike,

G j y k a t ë s i,